



Ngushtimi i Stomakut - Gastric Sleeve

Ky dokument ka për qëllim informimin e pacientit mbi shërbimet tona dhe procedurat që vijnë në marrjen e shërbimeve shëndetësore në spitalet tona partnere.



Dërgimi i Biletave dhe Takimi në Aeroport

Pasi të dakordoheni me ekipin tonë për datën e operacionit, ne do të punojmë me ju për të përcaktuar kohëzgjatjen e saktë të qëndrimit tuaj. Për të konfirmuar terminin në spital dhe hotel, për të bërë organizimin e pritjes në aeroport dhe përkthimin në spital, nga pacienti kërkohet të dërgohen biletat dhe pasaportat e pacientit dhe shoqëruesit.






Transporti Aeroport - Spital - Hotel dhe Anasjelltas

Pritja në aeroport dhe transporti aeroport - spital - hotel rezervohet konform datës dhe orës së arritjes. Ju lutemi të na informoni në rast vonese ose shtyerje të fluturimit. Fotografi dhe video që e tregojnë vendin dhe mënyrën e takimit në aeroport, do ju dërgohen para udhëtimit nga stafi ynë.



Ekzaminimet Mjekësore dhe Operimi

Në datën e dakorduar është bërë termini në Spitalin Medical Park te Prof. Dr. Samed Yardımcı për operacionin Gastric Sleeve ose siç njihet ndryshe Ngushtimi i Stomakut. Ju duhet të jeni në spital së paku një ditë para operimit për t'i bërë ekzaminimet pre-op, të cilat janë të detyrueshme para operacionit.

	Shpjegime mbi Shërbimet Tona	Kohëzgjatja
	Fluturimet për në Stamboll bëhen në dy aeroportet kryesore: Istanbul Airport (I.A) - pjesa evropiane e Stambollit dhe në Sabiha Gökçen (S.A) - pjesa aziatike e Stambollit.	e fluturimit (I.A) 01:10 h (S.A) 01:15 h
	Pritja në aeroport dhe transporti për në spital, hotel tashmë janë organizuar. Detajet mbi vend takimin në aeroport janë ndarë me juve përmes fotove dhe videove shpjeguese.	e udhëtimit (I.A) 01:15 h (S.A) 00:40 h
	Të gjitha terminet e nevojshme në spital, përcaktimi i përkthyesit/ses që do merret me juve dhe të gjitha aranzhimet tjera të nevojshme në lidhje me procesin e operimit janë bërë nga stafi ynë në Stamboll.	e qëndrimit 5 ditë (Spital)

Më tutje, gjeni informacione të detajuara mbi spitalin, doktorin, operacionin dhe detaje tjera me rëndësi mbi operacionin për ngushtimin e stomakut.



Informacione mbi Procedurat dhe Çmimin

Çka Përfshihet në Paketë?

Çmimi është çmim paketë. Në të përfshihen:

- ✓ Transporti tokësor brenda Stambollit: aeroport - spital/hotel dhe anasjelltas;
- ✓ 5 ditë akomodim në spital të kategorisë A+, me 3 shujta ditore të përfshira;
- ✓ Nëse është e nevojshme, qëndrimi në hotel 1 natë (bashkë me një shoqërues/e);
- ✓ Përkthimi dhe udhëzimet e nevojshme para dhe pas operimit deri në një vit;
- ✓ Këshillat e dietologes dhe plani ushqimor pas operacionit për 1 vit;
- ✓ Të gjitha medikamentet, proteinat dhe vitaminat;
- ✓ Për shoqëruesin/en nuk ka ndonjë kosto shtesë si në transport, hotel apo spital.
- ✓ Diagnostifikim i plotë (mini Check Up) – ekzaminimet e parapara në protokollin e operacionit, si:
 - Analizat e Përgjithshme të Gjakut;
 - EKG e Zemrës;
 - Rentgeni i Mushkërive;
 - Endoskopi me Anestezion;
 - Ultrazëri i Melçisë;
 - Takimi dhe Konsultimi Fillestar me **Kirurgun Operativ**, nga i cili mund të informoheni mbi operimin dhe specifikat e tij dhe po ashtu mund t'i shtroni pyetjet tuaja potenciale që mund t'i keni;
 - Ekzaminimi Paraprak **te Psikiatri**;
 - Ekzaminimi Paraprak **te Dietologu**;
 - Ekzaminimi Paraprak **te Anesteziologu**;
 - Ekzaminimi Paraprak **te Internisti** (kur shihet e nevojshme);
 - Ekzaminimi Paraprak **te Kardiologu** (kur shihet e nevojshme), dhe procedura të tjera spitalore të parapara me protokoll spitalor për operacionet bariatrike.



Ne jemi në dispozicionin tuaj çdo ditë në orarin 10:00-22:00; për pacientët tanë përgjatë trajtimit në Turqi, ekipi ynë në Stamboll është i qasshëm 7/24.



Informacione mbi Çmimin, Procedurat dhe Hotelin

Pagesa bëhet në spital në fillim të procedurave spitalore. Çmimet e ofertave tona janë pa TVSH. Plani dhe çmimi i trajtimit mund të pësojë ndryshime nëse pas ekzaminimeve që bëhen në spital, ndonjëri nga mjekët vjen në përfundim se për të dhënë aprovimin duhet të bëhen ekzaminime shtesë si p.sh EFOR, angiografi, scintigrafi ose të ngjashme. Në raste si kjo, çmimi mund të shtohet edhe për 500 – 1000 euro. Kërkesa të këtilla zakonisht bëhen te pacientët që kanë probleme me zemër dhe te ata mbi moshën 60 vjeçare. Çdo shërbim shtesë, jashtë atyre të përshkruara në këtë parakontratë, do të faturohet ndaras.

Qëndrimi në Turqi është i paraparë të jetë 5 ditë. Kohëzgjatja e qëndrimit mund të zgjatet në rrethana specifike si p.sh. nevoja për ekzaminime më të detajuara apo në rrethana kur mjeku kërkon t'a mbajë nën vëzhgim pacientin më gjatë. Ndryshimi i kohës së qëndrimit në Turqi apo ndryshimi i biletave, nuk janë të përfshira në paketë.

Çka nëse Anulohet Operacioni?

Në rast të dështimit të operacionit për arsye shëndetësore të evidentuara përgjatë ekzaminimeve spitalore, pacienti duhet të paguaj shumën nga 750 - 1000 euro për shpenzimet e transportit, përkthimit, qëndrimit në spital, ekzaminimet pre-op d.m.th ekzaminimet para operacionit etj. Pjesa tjetër e pagesës, kthehet menjëherë te pacienti.



Ne jemi në dispozicionin tuaj çdo ditë në orarin 10:00-22:00; për pacientët tanë përgjatë trajtimit në Turqi, ekipi ynë në Stamboll është i qasshëm 7/24.

Një Mjek - Shërbimet tona dhe Shërbimet e Spitalit

Një Mjek - Shërbimet Tona

Ne kemi marrë për sipër informimin e pacientit mbi procedurat që priten të zhvillohen në spital para ardhjes; organizimin e termineve të nevojshme në spital; organizimin e pritjes dhe kthimit mbrapa në aeroport; rezervimin e hotelit; përkthimin në spital; përcjelljen e gjendjes së pacientit deri në një vit pas operimit përmes kontaktit online me mjekun, kontaktin përmes telefonit ose takimet e rregullta me dietologun në zyrën tonë në Prishtinë, dhe ofrimin e të gjitha shërbimeve tjera mbi organizimin për të cilat ne jemi zotuar paraprakisht. Ne jemi në dispozicionin tuaj çdo ditë në orarin 09:00-16:30, ndërsa për pacientët tanë përgjatë trajtimit në Turqi, ekipi ynë në Stamboll është i qasshëm 24/7.



Shërbimet e Spitalit Partner



Të gjitha procedurat mjekësore që aplikohen te pacienti janë kompetencë dhe përgjegjësi e spitalit. Sipas protokollit mjekësorë, pacienti do t'informohet paraprakisht në detaje për të gjitha procedurat veç e veç nga personeli mjekësorë dhe para secilës procedurë do të kërkohet aprovimi i pacientit me anë të nënshkrimit. Me anë të nënshkrimit pacienti i pranon dhe i aprovon procedurat mjekësore dhe rrjedhimisht i merr përsipër personalisht të gjitha përgjegjësitë që pasojnë më tutje.

Akomodimi në Hotel

Akomodimi në hotel bëhet vetëm në rast nevojë. Hotelet tona partnere janë me 4 dhe 5 yje, zakonisht ndodhen afër spitalit, pranë bregdetit dhe kanë mëngjesin e përfshirë. Si në çdo hotel, koha e hyrjes (Check in) është në orën 14:00; koha e daljes (Check out) është në orën 12:00. Ne paguajmë për 1 dhomë (1-2 persona) dhe maksimumi për 1 natë. Për shkak të ekzaminimeve para operacionit, shtrirja e pacientit në spital bëhet 1 ditë para operacionit. Qëndrimi apo mos qëndrimi në hotel, nuk e ndikon çmimin e para dakorduar.

Ne jemi në dispozicionin tuaj çdo ditë në orarin 10:00-22:00; për pacientët tanë përgjatë trajtimit në Turqi, ekipi ynë në Stamboll është i qasshëm 7/24.

Të Rëndësishme


- ✓ Nëse dyshoni për probleme shëndetësore, veçanërisht ato me zemër apo me tiroide, bëni paraprakisht një kontroll te mjeku përkatës.
- ✓ Nëse konsumoni, 2 javë para operacionit ndërpriteni alkoolin;
- ✓ Nëse përdorni, 7-10 ditë para operacionit ndërprisni holluesit (antikoagulantët) e gjakut si Aspirinën dhe të ngjajshëm;
- ✓ Nëse përdorni, 2 javë para operacionit, ndërprisni çdo kontrceptiv hormonal pasi të konsultoheni me gjinekologun tuaj;
- ✓ 1 ditë para operacionit, nga ora 23:00 e tutje nuk lejohet të hahet ushqim apo të ngjashme, të pihet ujë apo pije të tjera, të tymoset duhan apo të ngjashme;
- ✓ Në përgjithësi para hyrjes në operacion, thonjtë rekomandohet të jenë të shkurtër dhe pa manikyr dhe çdo bizhuteri duhet të largohet;
- ✓ Pas operacionit pacienti rreptësisht e ka të ndaluar pirjen apo ngrënien deri sa të i bëhet me dije nga personeli përgjegjës i spitalit;
- ✓ Përdoruesit e substancave narkotike nuk mund të i nënshtrohen operacionit. Për t'u operuar duhet të kalojnë së paku 6 muaj nga hera e fundit që pacienti ka konsumuar substanca narkotike;
- ✓ Nëse me rekomandimin e mjekut ju kemi dërguar dietë para operacionit, ju lutemi të i përmbaheni dietës së dërguar në ditët e parapara;
- ✓ Pacienti pas operacionit duhet të i përmbahet udhëzimeve të mjekut dhe të dietologes.

Të Rekomandueshme

Para se të niseni, ju rekomandojmë të bëni një ofertë me MB dhe minuta të vlefshëm në Turqi.

Kur të arrini në aeroport Stamboll, ju rekomandojmë t'i këmbeni së paku 50-100 euro në Lira Turke për çfarëdo nevojë personale që mund të keni përgjatë qëndrimit në spital.

Dhoma e spitalit është e pajisur me të gjitha pajisjet higjienike që zakonisht i hasim në hotele. Ju rekomandojmë të keni me vete bizhama, papuçe (pantofla) dhe tuta sportive (trenerka).




Procesi i Operacionit dhe Rezultatet e Pritura

LLOJI, METODA DHE KOHËZGJATJA E OPERACIONIT

Gastric Sleeve është një nga operacionet më të njohura të humbjes së peshës në mbarë botën dhe jo vetëm që mund të sigurojë humbje efektive dhe afatgjatë të peshës, por edhe të lehtësojë gjendje të tjera mjekësore, si diabetin, presionin i lartë të gjakut etj. Një nga arsytet që procedura e ngushtimit të stomakut është bërë opsioni më i popullarizuar për humbjen e peshës është thjeshtësia relative e kryerjes së procedurës.

Gastric Sleeve kryhet duke përdorur një teknikë minimalisht invazive, laparoskopike. Procedura kryhet duke përdorur anestezi të përgjithshme në mënyrë që pacientët të jenë plotësisht në gjumë gjatë gjithë procedurës. Pasi të jeni nën anestezi, bëhen disa vrima-prerje të vogla në bark për të mundësuar depërtimin me kamerë dhe instrumente kirurgjikale.

Në operim përdoren stapler të specializuar kirurgjikal "three staple" - tri qepje, që presin dhe në të njëjtën kohë mbyllin lukthin tuaj. Me anë të kësaj procedure hiqet pjesa e zgjeruar e stomakut, duke zvogëluar kështu madhësinë e tij për rreth 75%. Operacioni në përgjithësi zgjatë përafërsisht 45 minuta. Sigurisht, para operimit bëhet një ekzaminim i plotë dhe i detajuar i pacientit (mini check up) për t'u siguruar se pacienti në aspektin mjekësor është i gatshëm për operim.



Gastric Sleeve ju Ndhmon të Humbni Peshë në 3 Mënyra

1

SASI MË E VOGËL USHQIMI

Operacioni zvogëlon madhësinë e stomakut tuaj për rreth 75%.

Pas operacionit, pacientët priren që të ndihen të ngopur pasi të kenë ngrënë vetëm një sasi të vogël ushqimi, kështu ju do ta krijoni ndjenjën e ngopjes më shpejtë se sa para operacionit. Kjo nënkupton se do të konsumoni më pak kalori ushqimore.

2

ZVOGËLON OREKSIN TUAJ

Hiqet pjesa më e madhe e stomakut përgjegjëse për prodhimin e ghrelinës.

Përveç zvogëlimit të madhësisë së tij, pjesa e stomakut të hequr përfshin pjesën më të madhe të pjesës përgjegjëse për prodhimin e ghrelinës; hormoni që stimulon oreksin tuaj duke dërguar sinjale urie në tru. Prodhimi më i ulët i ghrelinit do të thotë më pak sinjale urie dhe një reduktim në dëshirën tuaj për të ngrënë.

3

NDRYSHIMET HORMONALE

Ndryshimet hormonale gjithashtu priren të reduktojnë dëshirën për "ushqime nxitëse".

Ndryshimet hormonale që rezultojnë nga operacioni i ngushtimit të stomakut, gjithashtu priren të reduktojnë në mënyrë dramatike dëshirën e pacientit për "ushqime nxitëse" si ëmbëlsirat dhe karbohidratet.

Ne jemi në dispozicionin tuaj çdo ditë në orarin 10:00-22:00; për pacientët tanë përgjatë trajtimit në Turqi, ekipi ynë në Stamboll është i qasshëm 7/24.

Rreziqet e Mundshme dhe Periudha e Rikuperimit

Rreziqet e Mundshme në Operacionin e Ngushtimit të Lukthit

Nuk ekziston ndonjë operacion i cili nuk ka rreziqe, por këto mund të zbuten duke zgjedhur një doktor të kualifikuar dhe me përvojë të gjatë. Megjithatë, operacioni i ngushtimit apo reduktimit të stomakut është një prej operimeve me rrezik shumë të vogël, aq sa përmban rrezik operimi i apendiksit (zorrës qorre). Për t'a minimizuar në maksimum rrezikun, pacienti kalon nëpër ekzaminime të detajuara dhe nëse konstatohet që keni ndonjë rrezik apo pengesë për këtë operim, njoftoheni nga ana e mjekut përgjegjës dhe operimi shtyhet për një kohë deri sa merret një trajtim i nevojshëm ose anulohet në tërësi.

Vlenë të theksohet se rreziqet e operacionit janë shumë më të vogla sesa rreziqet që vijnë nga obeziteti dhe sëmundjeve të lidhura me të.

PERIUDHA E RIKUPERIMIT

Për shkak të qasjes minimalisht invazive, operacioni i ngushtimit të stomakut kërkon më pak kohë rikuperimi sesa në rastet tjera të ndërhyrjeve.

Rekomandohet që pacientët të kalojnë kohën e tyre në shtëpi duke qëndruar të hidratuar, dhe duke ju përmbajtur udhëzimeve të mjekut dhe dietologes.

Rikthimi në punë varet nga kërkesat fizike të punës suaj. Shumica e pacientëve kthehen në vendin e punës së tyre brenda një jave. Ngritja e peshave të rënda nuk lejohet në muajin e parë pas operacionit, prandaj kthimi në punë për ata që punojnë në sektore të këtilla, mund të jetë më i vonuar. Sidoqoftë, çdo pacient shërohet ndryshe, kështu që përvojat e tyre ndryshojnë në bazë të nevojave trupore, shëndetit dhe profesionit të tyre. Për tu siguruar se çdo gjë po shkon sipas planit, kontaktet tona me pacientin/en janë të vazhdueshme deri në 1 vit pas operimit. Doktorit do jetë i qasshëm online vazhdimisht për të i'u përgjigjur pyetjeve tuaja dhe për të dhënë vlerësimin mbi analizat të cilat mund të i rekomandohen pacientit për t'i bërë pas operimit.



Shërimi i Diabetit Tip II me Operacion

Ndikimi i Operacionit në Kurimin e Diabetit të Tipit 2



Hulumtimet tregojnë se deri në 80% e njerëzve nuk tregojnë shenja të diabetit të tipit 2 pas operacionit. Poashtu, njerëzit zakonisht humbin 60% deri në 80% të peshës së tyre shtesë. Krahas eliminimit të diabetit, pacientët zakonisht paraqesin nivele më të mira të presionit të gjakut, kolesterolit dhe triglicerideve. Në anën tjetër, vetëm 6% deri në 8% e njerëzve që marrin ilaçe, por nuk iu nënshtrohen operacionit, tregojnë rezultate të ngjashme.

Lidhja midis obezitetit dhe diabetit të tipit 2 është njohur prej kohësh. Obeziteti shoqërohet me ndryshime të ndryshme patofiziologjike që rrisin rezistencën ndaj insulinës. Prandaj, obeziteti mendohet të jetë faktori më i fortë i rrezikut për zhvillimin e diabetit të tipit 2. Mbi 90% e individëve me diabet të tipit 2 janë obezë, ndërkohë që rreziku nga shfaqja e diabetit është i lartë te pjesa më e madhe e individëve me obezitet.

Gastric Sleeve apo Gastric Bypass?

Si operacioni Gastric Bypass, ashtu edhe ai i Mëngës Gastrike (Gastric Sleeve) mund të jenë mjete efektive për të arritur humbjen afatgjatë të peshës.

Në operacionin Gastric Bypass, kirurgu bën një qese të vogël stomaku duke e ndarë pjesën e sipërme të stomakut nga pjesa tjetër e tij. Kur hahet, ushqimi shkon në qeskën e vogël dhe anashkalon majën e zorrës së hollë. Si rezultat shkaktohet ngopje më e shpejtë dhe thithje më pak të kalorive dhe lëndëve ushqyese. Ndërsa në operacionin Gastric Sleeve, kirurgu e heq një pjesë të madhe të stomakut. Si rezultat, me më pak vend për ushqim, ju ndiheni të ngopur më shpejt. Ky operacion gjithashtu ul grelinën, hormonin që ju bën të ndiheni të uritur.

Në përgjithësi mjekët rekomandojnë operacionin e bypass-it të stomakut për pacientët shumë obezë me masen e indeksit trupor shumë të lartë, sepse ka tendencë të çojë në humbje më të shpejtë dhe më të lartë të peshës në përgjithësi. Thënë kjo, procedura e bypass-it të stomakut është një operacion më i komplikuar, kështu që mjekët këshillojnë pacientët, e veqanërisht për cione të shumta abdominale tepër, koha e anestezisë është cionin e ngushtimit të stomakut përgjithësi e këshillojnë mënimi i stomakut siq njihet gjë-



DIETA PAS NGUSHTIMIT TË STOMAKUT



Në afat të shkurtër, do t'ju duhet të ndiqni udhëzime strikte ushqimore për t'u siguruar që stomaku juaj të shërohet mirë.

Një muaj pas operacionit, mund të filloni të hani një dietë më normale, por prapë do t'ju duhet të zgjidhni ushqimet tuaja me mençuri, për shkak se nuk do të jeni në gjendje të hani aq shumë sa më parë, do të duhet të siguroheni që ajo që hani ka mjaftueshëm vleraushqyese për të mbështetur nevojat tuaja për energji. Për këtë pjesë do të kujdeset dietologia jonë dhe do të punojë ngushtë me juve, në mënyrë që të jeni sa më të shëndetshëm dhe që të arrini rezultatin që ju dëshironi. Ju do të filloni të merrni vitamina menjëherë pas operacionit dhe do t'ju duhet të vazhdoni t'i merrni ato për një kohë të caktuar.

Humbja e Pritshme e Peshës

Mesatarisht, pacientët me stomak të zvogëluar, në muajin e parë pas operimit do të humbasin 8-12 kg të peshës së tyre të tepërt. Ndërkohë që në muajt në vazhdim, humbasin 3-5 kg deri të arrijnë në peshën e tyre ideale. Duhet të dini se mund të humbni më shumë ose më pak se kaq, secili organizëm ka cilësitë specifike. Disa njerëz që i kthehen zakoneve të këqija të të ngrënit humbasin më pak se kaq. Çelësi i suksesit është zbatimi i ndryshimeve të nevojshme dhe mësimi me shprehitë e reja të të ushqyerit.

Kujdesi Pasues - Këshillat e Dietologes Tonë për Një Vit



Dietologia jonë në Stamboll do jep sqarimet e detajuara mbi mënyrën e ushqimit për periudhën e parë katër javore pas operimit, kurse dietologia jonë në Prishtinë do e mbajë pacientin në kontakt të vazhdueshëm për 12 muajt në vijim për të përcjellur së bashku periudhën post-operative të pacientit. Të gjitha udhëzimet e shkruara post-operative mbi mënyrën e ushqimit ipen në gjuhën shqipe.



Ne jemi në dispozicionin tuaj çdo ditë në orarin 10:00-22:00; për pacientët tanë përgjatë trajtimit në Turqi, ekipi ynë në Stamboll është i qasshëm 7/24.

Doktori ynë i Besueshëm Prof. Dr. Samet Yardımcı

Prof. Dr Samed Yardımcı në karrieren e tij profesionale ka kryer me sukses mbi 2000 operacione për ngushtimin e lukthit apo siç njihet ndryshe gastric sleeve. Ka filluar studimet e tij për mjekësi në vitin 1997 në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Ankarasë. Filloi të punojë si asistent i kirurgjisë së përgjithshme në Spitalin Haydarpaşa Numune në vitin 2003.

Prof. Samedi u trajnua në Houston të ShBA-ve mbi kirurgjinë e kancerit dhe transplantimit të organeve midis 2008 dhe 2009. Poashtu ka marrë edukim profesional në Texas University në ShBA, në qendren spitalore Memorial Herrman. U trajnua në kirurgji gastroenterologjike (kirurgji e sistemit tretës) nga viti 2009 deri në 2012. Përveç punës në fushat e kirurgjisë së avancuar laparoskopike, obezitetit dhe kirurgjisë metabolike, transplantimit të organeve dhe kirurgjisë së sëmundjeve inflamatore të zorrëve, ai gjithashtu mori pjesë aktive në themelimin e këtyre fushave në spitale të ndryshme. Puna e tij në vitin 2012 i dha atij çmimin "Best Young Researcher" në Kongresin Ndërkombëtar të Transplantimit.

Fushat e tij të ekspertizës përfshijnë kirurgjinë e tumorit, kirurgjinë e refluksit, kirurgjinë e sëmundjeve inflamatore të zorrëve, kirurgjinë bariatrike dhe kirurgjinë metabolike. Nga marsi i vitit 2018 është i punësuar në spitalin Medical Park. Për më shumë informacione mbi mjekun klikoni mbi këtë link <https://www.njemjek.com/mjeket/prof-dr-samet-yardimci>



Partnerët Tanë



Spitali Medical Park



Spitali Biruni



Spitali Romatem



Spitali Emsey



Spitali LIV



Spitali Memorial



Spitali Medicana



Spitali Dünyagöz



Spitali Medicabil



Spitali Gaziosmanpaşa

Cilësia e shërbimit të këtyre spitaleve konfirmohet nga institucione akreditimi me famë botërore. Më shumë se 50 spitale turke janë të akredituara nga Komisioni i Përbashkët Ndërkombëtar (JCI).

Ne jemi në dispozicionin tuaj çdo ditë në orarin 10:00-22:00; për pacientët tanë përgjatë trajtimit në Turqi, ekipi ynë në Stamboll është i qasshëm 7/24.

Cilësia e Spitaleve Turke

Partnerët Tanë të Besueshëm

Spitalet tona partnere janë gjithmonë ndër spitalet më të mira në mbarë Turqinë. Ato kombinjnë teknologjitë më të fundit me staf specialist me përvojë dhe kompetent nga fusha të ndryshme mjekësore.

Cilësia e shërbimit të këtyre spitaleve konfirmohet nga institucione akreditimi me famë botërore. Më shumë se 50 spitale turke janë të akredituara nga Komisioni i Përbashkët Ndërkombëtar (JCI). Akreditimi i JCI është procesi i vlerësimit të përputhshmërisë së një institucioni shëndetësor me standardet e vendosura dhe të njohura ndërkombëtarisht. Spitalet turke renditen të dytat në botë të akredituara nga kjo organizatë.

Teknologji e Avancuar

Turqia ka bërë investime të konsiderueshme në infrastrukturën e saj mjekësore në vitet e fundit dhe shumë spitale dhe klinika janë të pajisura me teknologjinë më të fundit mjekësore. Kjo do të thotë që pacientët mund të marrin trajtime mjekësore dhe bëjnë operacione të cilësisë së lartë me pajisjet dhe teknologjinë më të fundit. Turqia ka një nga numrat më të lartë të sistemeve të kirurgjisë robotike në Evropë, i cili lejon operacione më të sakta dhe kohë më të shpejtë rikuperimi.


Staf të Trajnuar

Turqia ka një grup të madh mjekësh shumë të trajnuar, të cilët kanë përvojë në trajtimin e një game të gjerë të problemeve mjekësore. Shumë nga këta mjekë kanë marrë trajnimin e tyre mjekësor në Evropë ose Shtetet e Bashkuara dhe flasin rrjedhshëm anglisht ose gjuhë të tjera. Kjo do të thotë që pacientët mund të marrin kujdes mjekësor me cilësi të lartë nga mjekë me përvojë, të cilët mund të komunikojnë në mënyrë efektive me ta. Gjithashtu, shumë mjekë në Turqi kanë marrë certifikimin nga Bordi Amerikan i Specialiteteve Mjekësore, i cili është një kredencial shumë i respektuar në fushën mjekësore.



Ne jemi në dispozicionin tuaj çdo ditë në orarin 10:00-22:00; për pacientët tanë përgjatë trajtimit në Turqi, ekipi ynë në Stamboll është i qasshëm 7/24.


Shërbimet Mjekësore dhe Atraksionet Turistike



Për shkak të pozicionit të saj unik dhe të përshtatshëm gjeografik, Turqia është udhëkryqi i dy kontinenteve që kufizohen me Evropën. Mund të vizitohet lehtësisht dhe shpejtë me fluturime direkte nga shumica e vendeve. Turqia është në dispozicion për shumë vende të botës pa pasur nevojë për viza. Kjo e bën vendin edhe më të popullarizuar me pacientë nga e gjithë bota. Kombinimi i shërbimeve mjekësore dhe atraksioneve turistike të Turqisë u ofron pacientëve ndërkombëtarë mundësinë për ta kthyer trajtimin e tyre mjekësor në një pushim. Vendi është i njohur për trashëgiminë e tij të pasur kulturore, peisazhet e bukura dhe historinë e pasur, duke u ofruar pacientëve mundësinë për të eksploruar dhe shijuar gjithçka që ofron Turqia.

Linjat Tona të Komunikimit

Vizitoni faqet tona në **Facebook dhe Instagram**, në të cilat ne postojmë rregullisht **fotografi para dhe pas** të pacientëve tanë, gamë të gjerë temash, u **përgjigjemi pyetjeve** dhe kërkesave nga ndjekësit tanë dhe ofrojmë **informacione** të përditësuara.





Vizitoni Faqen Tonë të Përditësuar www.njemjek.com



<https://www.njemjek.com>



POLITIKAT E PRIVATËSISË

Përgjatë kontakteve tona fillestare, ju kemi ndarë me neve informacione mbi gjendjen tuaj shëndetësore dhe kemi dërguar raporte mjekësore. Informacionet e ndara me neve janë plotësisht konfidenciale dhe mbrohen sipas ligjeve në fuqi. Për informacione shtesë, shfletoni Politikat e Privatësisë së Qendrës së Konsulencës Mjekësore Një Mjek <https://www.njemjek.com/policies/politika-e-privat-sis-1>

Ne jemi në dispozicionin tuaj çdo ditë në orarin 10:00-22:00; për pacientët tanë përgjatë trajtimit në Turqi, ekipi ynë në Stamboll është i qasshëm 7/24.